



**ALBANIAN UNIVERSITY**

## **RAPORT VJETOR INSTITUCIONAL**

**Viti Akademik 2023 - 2024**

*AU - DHJETOR - 2024*

## HYRJE

“Albanian University” është institucion privat, i pavarur dhe ndër Universitetet e para private të hapura në Republikën e Shqipërisë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.197, datë 10.04.2004 dhe prej më shumë se një dekade operon me 3 (tre) Njësi Kryesore (Fakultete) dhe 9 (nëntë) njësi bazë (Departamente):

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
  - 1.1. Departamenti i Stomatologjisë
  - 1.2. Departamenti i Farmacisë
  - 1.3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
  - 2.1 Departamenti i Inxhinierive
  - 2.2 Departamenti i Shkencave Ekeonomike
  - 2.3 Departamenti i Art Dizajnit
3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore
  - 3.1. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
  - 3.2. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes
  - 3.3. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative

Ky vit akademik përkon edhe me 20-vjetorin e themelimit të institucionit.

Për vitin akademik 2023-2024, “Albanian University” ka aktive 39 programe studimi , prej të cilave 14 janë programe Bachelor, 11 programe Master Profesional, 7 programe Master i Shkencave, 4 Programe të Integruara të Nivelit të Dytë, 2 programe në Specializim Afatgjatë, 1 program me karakter profesional (Laborant i Lartë Dentar).

\*Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes për vitin akademik 2023-2024 ofron programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike me Urdhër hapje nga MAS Nr. 376, datë 14.07.2023. Programi zhvillohet 1 (një) semestër me 35 ECT, në formë studimi me kohë të plotë, ku në fund të studimeve studenti pajiset me një certifikatë.

“Albanian University”, ka kaluar me sukses procesin e akreditimit të 15 programeve të studimit dhe gjithashtu u aplikua për riakreditimin e 6 programeve të studimit.

Programet e studimit të ofruara nga “Albanian University” janë hartuar dhe zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përmbushur standardet shtetërore të cilësisë.

Për këtë vit akademik është aplikuar për hapjen e dy programeve të reja studimi si dhe për programin e studimit të ciklit të tretë (riorganizim): Doktoratë (hapje dhe riorganizim).

Gjithashtu, janë mbyllur 2(dy) programe studimi:

1. MP. Psikologji Klinike me Urdhër të MAS nr.273, datë 04.06.2024
2. BSc. Shkenca Poltiko-Administrative Urdhër të MAS nr.273, datë 04.06.2024.

Për vitin akademik 2023-2024 është rritur numri i aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi akademik si dhe numri i mobiliteteve si të studentëve dhe stafit akademik me Institucione të tjera të huaja të Arsimit të Lartë me qëllim shkëmbimin e

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

eksperiencave për përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies.

Më poshtë paraqitet raporti vjetor për universitetin privat “Albanian University” për vitin akademik 2023 - 2024, mbështetur në pikat e udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 të MAS Përcaktimin e Elementëve Përbërës të Raportimit Vjetor dhe Afatit për Raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24 datë 21.10.2019, si dhe referuar nenit 102 të Kushtetutës, nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*.

## Përmbajtja

<b>A. Senati Akademik .....</b>	<b>6</b>
<i>a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së .....</i>	<b>6</b>
<i>b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.....</i>	<b>7</b>
<i>c. Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin: .....</i>	<b>12</b>
<i>i) politikat e kërkimit shkencor.....</i>	<b>12</b>
<i>ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.....</i>	<b>13</b>
<i>iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit. ....</i>	<b>14</b>
<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional për vitin 2022-2023 dhe në vazhdim.....</i>	<b>27</b>
<i>iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor .....</i>	<b>43</b>
<i>d. Të dhëna mbi programet e studimit .....</i>	<b>47</b>
<i>i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar</i>	<b>47</b>
<i>ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.....</i>	<b>60</b>
<i>iii) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës</i>	<b>62</b>
<i>e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ....</i>	<b>62</b>

f. Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik .....	64
g. Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar: .....	65
i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar; .....	65
ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.....	73
h. Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .....	73
i. Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë, duke përfshirë edhe: .....	74
i) një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim; .....	74
ii) vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme.....	74
j. Të dhëna mbi studentët si: .....	75
i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;.....	75
ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioriteteve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore. ....	75
iii) numrin e studentëve të shkëlqyer; .....	75
iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;75	
v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit.....	75
vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre .....	83
vii) përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen.....	82
viii) një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi .....	83
<b>B. Bordi i Administrimit: .....</b>	<b>84</b>
a. Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse, etj. ....	84
b. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit .....	85

- c. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim 85
- d. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore .....85
- e. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare .....85
- f. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimit, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë. ....86

### A. Senati Akademik:

a) *Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.*

Plani Strategjik Institucional është dokumenti i planifikimit që përshkruan misionin, objektivat strategjikë dhe akademikë të Universitetit.

Në mbështetje të Planit Strategjik Institucional **2023 - 2028** në “Albanian University”, i cili ka në fokus përmbushjen e misionit të institucionit, por edhe ruajtjen e vazhdimësisë së objektivave të hartuara nga “Plani Strategjik 2017-2022.

Për vitin akademik 2023-2024, qëllimet dhe objektivat kryesore të mësimdhënies janë përmbushur në mënyrë cilësore, nisur edhe nga raportet e njësive bazë dhe njësive kryesore.

Gjithashtu, është punuar në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie, kjo falë edhe trajnimeve të realizuara me stafin akademik, me profesorë vendas dhe të huaj me fokus metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar *feedback*-ut të marrë nga studentët (nëpërmjet realizimit të pyetësorëve 2 herë në vit dhe fokus grupeve një herë në vit) si dhe *feedback*-ut nga pedagogët (nëpërmjet pyetësorëve drejtuar stafit akademik për të marrë informacion mbi përshtypjen e tyre ndaj institucionit).

Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësie bazë, ka qëllim të promovojë praktikën e mira, të nxisë vazhdimësinë e tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Në kuadër të realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë AU ka implementuar raportin vjetor të vetëvlerësimit të programeve të studimit, në mënyrë që të evidentohen informacione në lidhje me progresin e programeve dhe pikat ku ka nevojë për përmirësim në të ardhmen.

Për sa i përket kërkimit shkencor, fushë e cila mbulohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akadematike, informacioni implementohet nëpërmjet formularit të veprimtarisë kërkimore shkencore si dhe pjesëmarrjes nëpër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për vitin akademik 2023-2024 është rritur numri i publikimeve në Scopus, kjo falë mbështetjes financiare nga institucioni me miratimin e fondit prej 50.000 euro.

b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.

### Projekte të fituara

Tabela 1

N r	DATA APLIKIM	TITULLI I PROJEKTI	THIRRJA	DONATORI	INSTITUCIONI APLIKUESE	STADI	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
1	31.01.2023	NEOLAiA - Transforming Regions for an Inclusive Europe	ERASMUS -EDU-2023-EUR-UNIV	European Commission	Albanian University	Fituar	NEOLAiA është një projekt që synon të kultivojë dhe zgjerohet njohuria në një aleancë të ngushtë të nëntë institucioneve të reja arsimit të lartë dhe në zhvillim dinamik, të bazuar në qytete të vogla dhe të mesme në katër rajone evropiane përtej metropolitëve. AU është partner i asociuar duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve.
2	28.02.2023	DUAL LEARNING FOR ALBANIA ZALL.L	ERASMUS-EDU-2023-CB-VET	European Commission	Albanian University	Aktiv	ZALL.L synon të trajtojë çështjet që janë shfaqur në arsimin fillestar dhe të vazhdueshëm të AFP-së në Shqipëri, me referencë të veçantë në sektorin turizëm-rural dhe duke u mbështetur në prioritetet e ETF-së për veprim për zhvillimin e kapitalit njerëzor në vend.



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

3	15.09.2024	The Living Lab for Innovative Creators Phase II	Giz Albania	European Commission	Albanian University	Fituar	Projekti do të shërbejë si një laborator për krijuesit novatorë duke rritur kapacitetin e mësuesve dhe nxënësve për sipërmarrjen, teknologjinë, qasjen e gjelbër, inovacionin Faza II
4	20.03.2023	The Living Lab for Innovative Creators Phase I	Giz Albania	European Commission	Albanian University	Perfunduar	Krijimi i një habitati për krijuesit novatorë duke rritur kapacitetin e mësuesve dhe nxënësve për sipërmarrjen, teknologjinë, qasjen e gjelbër, inovacionin Faza I
5	29.03.2023	Agile and Flexible Construction Materials Standardization for Boosting the Twin Transition AFCOS	HORIZON-CSA	European Commission	Albanian University	Fituar	Krijimi i proceseve të standardizimit më të zhdervjelleta për materialet e ndërtimit. Kjo nismë i ka rrënjët në kërkimet parnormative të kryera në bashkëpunim në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë kërkimin, standardizimin dhe aktorët industrialë një gamë të gjerë vendesh evropiane.
6	2022-2026	Research Infrastructure for the Study of Religion-Preparatory Phase RESILIENCE	HORIZON EUROPE HORIZON-INFRA-2021-DEV-02	European Commission	Albanian University	Aktiv	RESILIENCE është një infrastrukturë kërkimore ndërdisiplinore evropiane që i shërben studimit të fesë në të gjitha fushat akademike. Ai lidh qendrat kërkimore, mbajtësit e të dhënave dhe

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

							shërbimet e shpërndara në të gjithë Evropën dhe krijon instrumente dhe shërbime të reja për komunitetin e saj shkencor.
7		Virtual Exchanges of Active Citizens	ERASMUS-EDU-2022-CB-VET	European Commission	Albanian University	16.09.2022	Ky projekt fokusohet në shkëmbimet virtuale që fuqizojnë përfshirjen e qytetarëve aktivë në të gjithë Evropën, duke nxitur dialogun dhe bashkëpunimin ndërkulturor.
8	07.03.2024	Perhapja e deficiences se Vitamines D ne Shqiperi lidhur me nje ekspozim jo te efektshem ne diell	PKKZH 2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aktiv	Studim mbi perhapjen e deficiences se Vitamines D ne Shqiperi lidhur me nje ekspozim jo te efektshem ne diell.
9	11.03.2024	Vleresimi i ekspozimit te ndotjes se ajrit te brendshem ne shkollat 9 vjecare ne Shqiperi	PKKZH 2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aktiv	Studim mbi ekspozimit te ndotjes se ajrit te brendshem ne shkollat 9 vjecare ne Shqiperi
10	23.06.2023	Studim mbi njohurite , Qendrimet dhe praktiket mbi perdorimin e antibiotikeve ne kujdesin shendetesor paresor. Optimizimi i perdorimit te antibiotikeve per perballimin e krizes se antibioretences.	AKKSHI Bilaterale me Kosoven	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Projekt i fituar	Studim mbi njohurite , Qendrimet dhe praktiket mbi perdorimin e antibiotikeve ne kujdesin shendetesor paresor. Optimizimi i perdorimit te antibiotikeve per perballimin e krizes se antibioretences

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

11	17.07.2023	Know-how Exchange Programme (KEP)	CEI	European Commission	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Projekt i fituar	Vleresimi i ndotjes se ujit dhe ajrit ne Shqiperi
12	17.03.2024	Përfitimet e veprimit fizik në shkatërrimin e biofilmit bakterial në peri-implantite	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aplikuar-Jo fitues	Studim mbi veprimin fizik në shkatërrimin e biofilmit bakterial në peri-implantite
13	07.03.2024	“INFOBARNA - Regjistri Digjital Kombëtar i Barnave në Shqipëri: Platforma e sigurisë së pacientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në shëndetësi përmes forcimit të informimit të besueshëm të profesionistëve dhe publikut”	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aplikuar-Jo fitues	Krijimi i nje Regjistri Digjital Kombëtar i Barnave në Shqipëri ne lidhje me informimin
14	11.03.2024	“Pasurimi i stilit bisedor te të rinjtë përmes diskursit në auditor”.	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqerore	Aplikuar-Jo fitues	Vleresim dhe studim te stilit bisedor te të rinjtë përmes diskursit në auditor
15	8.03.2024	Hartimi i shkallëve të vlerësimit në përcaktimin e aftësive të të nxëniet tek adultët me çrregullim të spektrit autik.	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Shoqerore	Aplikuar-Jo fitues	Përcaktimi i aftësive të të nxëniet tek adultët me çrregullim të spektrit autik
16	11.03.2024	“Hetimi i efekteve anti-inflamatore dhe karakterizimi i profilit farmalogjik të Salvia officinalis e rritur në rajone të ndryshme të vendit tonë”	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aplikuar-Jo fitues	Sherebela dhe karakterizimi i profilit farmalogjik te tij.
17	06.03.2024	Perhapja e kariesit veseve dhe disfeksioneve orale dhe rendesa e malokluzionit ne femijet e moshes parashkollore	AKKSHI PKKZH2024	AKKSHI	Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekesore	Aplikuar-Jo fitues	Depistim i e kariesit veseve dhe disfeksioneve orale dhe rendesa e malokluzionit ne femijet e moshes parashkollore

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

18	26.12.2023	Patient Safety and Sustainable Healthcare through Strengthening Pharmacovigilance in WB	WESTERN BALCAN FUND 6-th call	European Commission	Albanian University,	Aplikuar-Jo fitues	Perforcimi i sistemit te Farmakovigjilences ne Shqiperi
19	26.12.2023	Female Political Discourse in Western Balkans Legislative Bodies	WESTERN BALCAN FUND 6-th call	European Commission	Albanian University,	Aplikuar-Jo fitues	Promovimi i figurave femerore ne Organet Legjislative
20	26.12.2023	Development and delivery of a training program for the integrated management of autism	WESTERN BALCAN FUND 6-th call	European Commission	Albanian University,	Aplikuar-Jo fitues	Miremenaxhimi i Autizmit përmes Zhvillimit te programeve trajnuese

Burimi i të dhënave të mëposhtme për pjesëmarrjen në Cost është sipas Formularit të vetëvlerësimit të pedagogëve realizuar nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike të plotësuar në fund të vitit akademik përkatës.

**Tabela 2**

	Viti akademik 2023-2024								
	Fakulteti i Shkencave Shoqërore			Fakulteti i Shkencave Mjekësore			Fakulteti i Shkencave te aplikuar dhe Ekonomike		
	DEA	DP	DSHJPA	DIF	DF	DS	DI	DAD	DE
Cost Member	2	1	3	0	3	2	18	2	0
MC member					1		9		
Science Communicator Cost							1		
						Total	31		

Një COST Action është një rrjet kërkimesh ndërdisiplinor që bashkon kërkues dhe inovatorë për të hetuar një temë të zgjedhur. COST Actions zakonisht përbëhen nga kërkues nga akademja, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, institucione publike dhe organizata të tjera.

Në kuadër të 'Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2021-2024', Albanian University ka nxitur pjesëmarrjen e stafit akademik përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të dedikuara rreth COST të organizuara nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

Në vitin akademik 2023-2024 gjenden 31 pedagogë të stafit akademik në nivel institucional të përfshirë në thirrjet COST me shpërndarjen sipas njësive bazë e kryesore në tabelën ilustruese.

c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:

i) politikat e kërkimit shkencor;

“Albanian University”, në fushat e studimit, kërkimit shkencor dhe të zhvillimit ka hartuar dhe ndjek një strategji e cila është në funksion të politikave tërësore të universitetit.

Universiteti ka një strukturë efektive, e cila përbëhet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike dhe departamentet/Fakultetet. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor është nën përgjegjësinë e një drejtuesi me gradë shkencore ose titull akademik.

Pranë Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor është ngritur Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet, i cili drejton dhe orienton politikat e veprimtarisë botuese të Albanian University, ku përfshihet dhe revista shkencore “OPTIME”.

Aktiviteti në lëmin kërkimor shkencor i “Albanian University” bazohet, organizohet dhe zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Senati i Universitetit me propozim të Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike miraton strategjinë bazë të kërkimit shkencor, strategji që shërben si rrëfyese për të tre Fakultetet e AU.

Kjo strategji përçohet në të gjitha departamentet dhe konkretizohet hollësisht në planifikime e zbatime specifike gjatë çdo viti akademik, me realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar; me studime e projekte për zhvillim, si dhe në veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave të gjithësecilit, duke mbështetur veprimtarinë e stafit akademik për aftësimin dhe kualifikimin e tij jo vetëm në procesin e mësimdhënies, por edhe atë shkencor.

Në vijim, kërkohet të krijohet një raport i drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formohen shprehje të punës dhe të metodave kërkimore shkencore tek studentët, duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen e tyre në grupe studimore e projekte që kanë departamentet, fakultetet ose universiteti.

Politikat e “Albanian University” në fushën e kërkimit shkencor janë në funksion të misionit të institucionit dhe të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë kuadër, Institucioni është i angazhuar të ndër marrë një sërë politikash, me qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor, si më poshtë:

- Ngritja e strukturave institucionale në funksion të mbështetjes dhe nxitjes së kërkimit shkencor,
- Ngritja e kapaciteteve infrastrukture në funksion të zhvillimit të kërkimit shkencor,
- Nxitja dhe fuqizimi i bashkëpunimeve me institucione homologe, biznese, qendra kërkimore dhe entite të tjera të angazhuara në kërkim shkencor, brenda dhe jashtë vendit,
- Integrimi në programe të ndryshme europiane si Erasmus+, CEEPUS, Horizon 2020, COST etj.,
- Nxitja e interesit dhe motivimi i stafit akademik dhe studentëve në drejtim të kërkimit shkencor.

Objektivat strategjikë për zhvillimin e kërkimit shkencor konsistojnë në:

- ❖ Forcimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor bazë përmes temave të diplomave, detyrave dhe projekteve të studentëve etj.,
- ❖ Ngritjen e grupeve të mirëfillta kërkimore - shkencore në fusha të përafërta dhe me objektiva të përcaktuara qartë,
- ❖ Ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për të realizuar kërkim - shkencor të aplikuar,
- ❖ Rekrutimin e vazhdueshëm të stafit me orientim kërkimor - shkencor,
- ❖ Pjesëmarrjen në projekte kërkimore - shkencore të mirëfillta kombëtare dhe ndërkombëtare,
- ❖ Zhvillimin e kërkimit shkencor për të tretët,  
Riorganizimin dhe hapjen e programeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në vazhdim të tij.  
Përmirësimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimeve në revistatë stafit me produkte të kërkimeve shkencore gjithmonë e më cilësore,
- ❖ Ngritjen e revistës së Universitetit “Optime” në një revistë ndërkombëtare të indeksuar.

### *ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;*

Mësimdhënia në “Albanian University” është e lidhur ngushtë me kërkimin shkencor e reflektuar kjo me realizimin e studimeve apo projekteve kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik. Rezultatet e studimeve bëhen objekt diskutimesh përgjatë orëve në auditor me studentët me qëllim motivimin e studentëve për t’u afruar me kërkimin shkencor, si dhe zhvillimi i detyrave të kursit, ku studentët zhvillojnë aftësitë e tyre mbi metodologjitë në kuadër të kërkimit shkencor. Gjithashtu, përgjatë vitit akademik organizohen konferenca shkencore studentore, ku studentët prezantojnë rezultatet e punëve shkencore të realizuara me mbështetjen e stafit akademik.

Këtë vit akademik për 20-vjetorin e universitetit u zhvillua konferenca ndërkombëtare multidisiplinare nga të tre Fakultetet në fusha të ndryshme të mjekësisë, ekonomisë, inxhinierisë, art dizajnit, psikologjisë, juridikut me një pjesëmarrje të gjerë, jo vetëm të stafit akademik, të ftuar, por edhe studentëve.

*iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit*

**Tabela 3**

<b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE)</b>		
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Inxhinierive (DI)</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj)</b>
Konferencën ndërkombëtare me rastin e 20 - vjetorit të Albanian University “Innovation and Sustainability: Challenges for a better future” - 26-27.04.2024	Leksion i hapur në kuadër të shkëmbimit Erasmus+ me Universitetin Arktik të Norvegjisë zhvilluar nga Shemin Sagaria - 21-24.11.2023	Vizita e nxënësve dhe mësuesve të shkollës “Beqir Çela” në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit AU-ICLA dhe projektit 'Living Lab Innovet' - 09.11.2023
	Leksion i hapur në kuadër të shkëmbimit Erasmus+ me Universitetin Arktik të Norvegjisë zhvilluar nga Yngve Birkelund - 22-25.04.2024	Vizita e studentëve të programeve të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” dhe “Inxhinieri Elektrike” tek shkolla profesionale “Beqir Çela” në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit AU-ICLA dhe projektit 'Living Lab Innovet' - 24.11.2023
	Leksion i hapur “Informim mbi rendesine e përdorimit të AI në disiplina të ndryshme” - 17.07.2024	Vizita e studentëve të programeve të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” dhe “Inxhinieri Elektrike” në TEC-in e Vlorës - 21.01.2024.  Workshop “Modeli Kornizë për Inovacionin në Arsimin Profesional” në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit AU-ICLA dhe projektit 'Living Lab Innovet' - 23.02.2024

**Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Art-Dizajnit (DAD)**

<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
-------------------	---------------------------	---

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

Konferencën ndërkombëtare me rastin e 20 - vjetorit të Albanian University "Innovation and Sustainability: Challenges for a better future" - 26-27.04.2024		
<b>Departamenti i Shkencave Ekonomike</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
Konferencën ndërkombëtare me rastin e 20 - vjetorit të Albanian University "Innovation and Sustainability: Challenges for a better future" - 26-27.04.2024		
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b>		
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Stomatologjisë</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<b>26-27 Prill 2024</b> - Konferenca e 20-të Ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore "Kontributi akademik dhe shkencor i Albanian University në 20 vjet histori,"	<b>11.10.2023</b> - Leksion i hapur: Ergonomia dentare Erasmus+, Sofia University, Dr. Tsokov  <b>25.10.2023</b> - Leksion i hapur: Koncepte themelore mbi përgatitjen e temës së Diplomës nga Dr. Loreta Aranitasi  <b>29.02.2024</b> - Leksion i hapur: Përpunimi statistikor në fushën e mjekësisë nga Prof. Asoc. Elida Mataj	<b>17.11.2023</b> - New Vertysystem protocol. From Digital to Analog. Dep Stom, FSHM, AU & VERTYSYSTEM <b>19.03.2024</b> -Emuloni natyrën: nga vëzhgimi te zbatimi i përditshëm. Dep Stom, FSHM, AU, (Djemal Ibrahim)  <b>6.03.2024</b> Urgjencat mjekësore Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore (Dr. Skender Brataj)
<b>7-8 Qershor 2024</b> - ICMS International Conference of Medical Sciences	<b>7.03.2024</b> - Leksion i hapur Prof. Giovanni Falisi Disfunzioni temporomandibolari inquadramento nosologico e trattamento  <b>18.04.2024</b> - Leksion i hapur	<b>25.05.2024</b> - Theory and Practice from Wax to Ceramic nga Mdt. Enzo Casale Dep Stom - Laborant i Larte Dentar, FSHM, AU



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

<p><b>14-16 Shtator 2023-</b> Kongresi i 5-të Ndërkombëtar: “Innovazioni tecnologjike e protocolli sperimentali in Parodontologia, Chirurgia Orale e Ortognantodonzia” Bari, Itali</p>	<p>Shëndeti seksual nga Prof.Asoc. Lumturi Mërkuri</p> <p><b>20.04.2024</b> - Aktivitet promocional Dita Botërore e Shëndetit Oral</p> <p><b>12.02.2024</b> - Leksion i hapur Frontiers of innovation in autologous fat grafting: Safeguarding Adipose-Derived Cells and unveiling their significance in regenerative medicine nga Dr.Hebert Lamblet</p> <p><b>08.04.2024</b> - Leksion i hapur Etika në kërkimin shkencor nga Prof. Dr. Elizana Petrela</p>	<p><b>1-6.07.2024</b>-Leksione dhe workshope ne kuader te Summer School 2024 me George Mason College FSHM, AU&amp; George Mason College</p> <p><b>17-18.05.2024</b> - Inovacione dhe strategji mbi implantet (Implant surgery).</p>
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga Departamenti i Farmacisë</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<p><b>26-27 Prill 2024</b> - Konferenca e 20-të Ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore "Kontributi akademik dhe shkencor i Albanian University në 20 vjet histori,"</p> <p style="text-align: center;">Konferenca Ndërkombëtare në Shkenca Farmaceutike IX</p>	<p>Tema "Përgatitja e Temës së Diplomës për Punime të Kërkimit Shkencor dhe Epidemiologjike" (<i>D. Xhafaj</i>)</p> <p>"Metodat e avancuara të Kërkimit Shkencor" (<i>E. Mataj</i>)</p>	<p>Covid -10 Qasje te rela dhe trajtimi me suplementet njekendveshtrim ndryshe (S. Cenaj - Univeristet i Shkupit- Maqedoni)</p>
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Infermierisë &amp; Fizioterapisë</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<p><b>26-27 Prill 2024</b> - Konferenca e 20-të Ndërkombëtare e Shkencave Mjekësore "Kontributi akademik dhe shkencor i Albanian</p>	<p><b>19.12.2023</b> Robofizz, teknologjia e fundit e fizioterapisë</p> <p><b>19.01.2024</b> Intervista e suksesshme dhe vlerësimi nga punëdhënësi</p>	<p><b>01.02.2024 (Takim)</b> Mundësitë për Integrimin e Infermierëve Shqiptar në sistemin Shëndetësor Gjerman</p> <p><b>13.03.2024 (Workshop)</b> Sfidat e infermierëve në urgjencat shëndetësore</p>

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

<p>University në 20 vjet histori,"</p>	<p>Kujdesi infermierior në parandalimin e sëmundjeve dhe menaxhimi e komplikacioneve të tyre</p> <p>Për një rini pa duhan</p> <p><b>17.04.2024</b> Kujdesi terapeutik në rehabilitimin e hershëm neurologjik</p> <p><b>21.05.2024</b></p> <p>Figura e profesionitëve të kujdesit shëndetësor, sfidat e karrierës dhe praktikatat e licensimit</p>	<p><b>10.05.2024 (Sesion informues)</b> Sfidat e infermierit dhe punësimit pas diplomimit</p> <p><b>15.05.2024 (Webinar)</b> Promoting Health Across LIFE-SPAN</p> <p><b>20.05.2024 (Open Day)</b></p> <p>Prezantim i Masterit Profesional Terapi Manuale dhe Infermieri Kirurgjikale</p>
<b>Fakulteti i Shkencave Shoqërore</b>		
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Edukimit dhe Anglishtes</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<p><b>26-27 Prill 2024</b> Konferenca Ndërkombëtare me temë “ Sfidat e Ballkanit Perëndimor për Forcimin e Shtetit të së Drejtës dhe Luftës kundër Korrupsionit dhe Kriminalitetit” organizuar nga FSHSH</p>	<p><b>7 dhjetor 2023</b> - Leksion i hapur me temë “ Cështje të Barazisë Gjinore dhe të drejtat e grave në Shqipëri” në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, mbajtur nga Adena Vagjeli - Drejtore ekzekutive e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri dhe Migena Ismailati - Përgjegjëse e Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, Bashkia Tiranë.</p> <p><b>Dhjetor 2023</b> - Cikël i Trajnimeve në kuadër të Hartimit dhe Shkrimit të Projekteve të organizuara nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit shkencor dhe Botimeve Akademike</p> <p><b>6 Shkurt 2024</b> - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizoi trajnimin me temë “ Nevojat emocionale të studentëve” nën referimin e Përgjegjëses së Psikologjisë së Përgjithshme Dr. Arbjola Halimi</p> <p><b>Prill 2024</b> - Fourm Akademik - Prof.Fehmi Agani-akademiku Martir i Kombit dhe i Shkencës - Organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore</p>	<p><b>Dhjetor 2023</b> - Në kuadër të infrastrukturës kërkimore shkencore europiane RESILIENCE, “Albanian University” në bashkëpunim me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë zhvilluan aktivitetin me temë “Si të bëjmë një intervistë”</p> <p><b>Shkurt 2024</b> - Studentët e Departamenteve të Edukimit dhe Anglishtes dhe Psikologjisë së Përgjithshme të “Albanian University” marrin pjesë në kuadrin e veprimtarive kushtuar Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe “në ditën e katërt në “Ditët e drejtshkrimit”, me temë: Shqipja e njësuar dhe të folmet arbëreshe” organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog (COD) në Bibliotekën e Kryeministrit në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.</p> <p>Mundësi bashkëpunimi midis <b>Albanian</b></p>

	<p><b>1-5 Prill 2024</b> - Aktivitet shkencor - Politikat, Filozofia dhe Ekonomia e Shqipërisë Post-komuniste: shqyrtimi i efektivitetit institucional, shëndet ekonomik dhe produktivitetit të punës.</p> <p><b>16 Maj 2024</b> -Simpozium shkencor - At' Gjergj Fishta figurë e shquar e veprimtarisë klerike, arsimore, politike, diplomatike dhe artistike, që ka lënë gjurmë në historinë kombëtare. Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit RESILIENCE</p> <p><b>11 Qershor 2024</b> - Trajnim- Modeli i Zhvillimit Profesional - Prof.Asoc.Valbona Loshi/Dr. Elda Gjergji</p>	<p><b>University dhe Afyon Kocatepe University, Turqi.</b> Në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit ditën e martë datë 23.01.2024 pranë ambienteve të Albanian University ishin <b>Assoc. Prof. Dr. Fatih Güngör</b> - Zv.Rektor i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë si dhe <b>Turan Ulaş</b> - Ekspert pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, nga <b>Afyon Kocatepe University, Turqi.</b></p> <p><b>21 shkurt 2024</b> - Aktivitet shkencor i “Albanian University” me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë në kuadër të projektit evropian RESILIENCE Në datën 21 shkurt 2024 në kuadër të zbatimit të projektit evropian RESILIENCE u zhvillua në sallën e bibliotekës së AU-së aktiviteti shkencor, i mundësuar nga bashkëpunimi i “Albanian University” me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja. Hapja e aktivitetit u bë nga Prof. Dr. Kaliopi Naska, e cila u ndal në rëndësinë e angazhimit të “Albanian University” në këtë projekt evropian, duke evidentuar kulturën, trashëgiminë kulturore, historinë dhe vlerat e krijuara dhe të ruajtura ndër shekuj nga këto komunitete në Shqipëri. Përmes</p> <p>infrastrukturës kërkimore shkencore do të nxirren në pah dhe thesaret e kulturës fetare shqiptare, në rishikimin e historisë së kombit shqiptar. Më tej aktiviteti u përqendrua në kumtimin e Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja, lektor në Universitetin Bedër, i cili trajtoi temën: “Historia e Bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri: ecuri dhe sfida”. Ai shpalosi me dokumente dhe argumente ecurinë e kësaj bashkëjetese ndërfetare në Shqipëri, duke e shoqëruar dhe me</p>
--	--	---

		<p>sfidat përkatëse të Dialogut Ndërfetar.</p> <p>Duke qënë dhe ekspert i jashtëm në OSCE/ODIHR për lirinë e besimit dhe së fundmi dhe President i Këshillave Ndërfetarë të Europës (European National Interreligious Bodies, Religions for Peace Europe) solli dhe përvojën evropiane në këtë fushë, duke nxjerrë në pah shtrirjen e dialogut, mirëkuptimin e ndërsjelltë për bashkëjetesën paqësore ndërmjet feve me synimin diversitetin fetar. Studentët dhe pedagogët që ishin prezen patën mundësinë të përfitonin njohuri të çmuara rreth rolit të bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri dhe u treguan aktiv me pyetjet dhe diskutimet e bëra. Në përfundim të aktivitetit Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja i dhuroi bibliotekës së AU-së botimin e monografisë së tij: “Historia e Dialogut Ndërfetar” 2023, ku iu shprehën dhe falënderimet. Në sajë të punës studimore, botimeve shkencore në këtë fushë, pjesëmarrjes në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe eksperiencave të tij.</p> <p><b>23 shkurt 2024</b> - Workshop “Modeli Kornizë për Inovacionin në Arsimin Profesional”. AU në bashkëpunim me Ekipin InnoVET 3. Në këtë workshop morën pjesë drejtues shkolle, partner, kolegë dhe studentë.</p> <p><b>9 Mars 2024</b> - Vizitë Muzeun Onufri - Muzeu Ikonografik Onufri, historia dhe pasuria artistike në sfidën e kohës- Organizuar në kuadër të projektit RESILIENCE</p> <p><b>22 Prill 2024</b> -Workshop - Diplomacia dhe Kultura - organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog (COD)/Biblioteka e Kryeministrisë me pjesëmarrjen e studentëve dhe lektore Dr. Esmeralda Strori</p>
--	--	---

## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2023-2024

		<p><b>8 Maj 2024</b> - Panairi i punës organizuar nga - Zyra e Karrierës dhe Alumnit</p> <p><b>11 Maj 2024</b> - OPEN DAY - organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore me pjesëmarrjen e maturantëve të disa gjimazeve.</p>
<b>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<p><b>26-27 Prill 2024</b> “Sfidat e Ballaknit Perëndimor Për Forcimin e Shtetit të së Drejtës dhe Luftës Kundër Korrupsionit dhe Kriminalitetit”</p>	<p><b>02. 02. 2024</b> Trajnim i Stafit Akademik të Albanian University organizuar nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në AU me tematikë: “Nevojat Emocionale të Studentëve”. Trajnues: Dr. Arbjola Halimi</p> <p><b>15. 02. 24</b> Leksion i Hapur me Lektorë të Huaj (me tematikë: Kompleksi i Edipit. Diferenca midis Sigmund Freud dhe Alfred Adler. Dr. Francesca Molina) me kontributin e pedagoge Dr. Irena Hysenaj</p> <p><b>15.05.24</b> Leksion i Hapur, Manuela Zambianchi, ISIA, Faenza, me tematikë “Promoting Health across life-span” në bashkëpunim me Departamentin e Infermierisë në AU.</p>	<p><b>Dhjetor 2023</b> - Në kuadër të infrastrukturës kërkimore shkencore europiane RESILIENCE, “Albanian University” në bashkëpunim me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë zhvilluan aktivitetin me temë “Si të bëjmë një intervistë” Mundësi bashkëpunimi midis Albanian University dhe Afyon Kocatepe University, Turqi. Në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit ditën e martë datë <b>23.01.2024</b> pranë ambienteve të Albanian University ishin Assoc. Prof. Dr. Fatih Güngör - Zv.Rektor i Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë si dhe Turan Ulaş - Ekspert pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, nga Afyon Kocatepe University, Turqi.</p> <p><b>21 shkurt 2024</b> - Aktivitet shkencor i “Albanian University” me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë në kuadër të projektit evropian RESILIENCE <b>Në datën 21 shkurt 2024</b> në kuadër të zbatimit të projektit evropian RESILIENCE u zhvillua në sallën e bibliotekës së AU-së aktiviteti shkencor, i mundësuar nga bashkëpunimi i “Albanian</p>

		<p>University” me Këshillin Ndërfetar të Shqipërisë të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm i saj Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja.</p> <p>Në përfundim të aktivitetit Prof. Asoc. Dr. Genti Kruja i dhuroi bibliotekës së AU-së botimin e monografisë së tij: “Historia e Dialogut Ndërfetar” 2023, ku iu shprehën dhe falënderimet. Në sajë të punës studimore, botimeve shkencore në këtë fushë, pjesëmarrjes në shumë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe eksperiencave të tij.</p> <p><b>23 shkurt 2024</b> - Workshop “Modeli Kornizë për Inovacionin në Arsimin Profesional”. AU në bashkëpunim me Ekipin InnoVET 3. Në këtë workshop morën pjesë drejtues shkolle, partner, kolegë dhe studentë.</p> <p>Në kuadër të projektit evropian RESILIENCE, Albanian University në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Qendrës Kombëtare Muzeore, Berat, më datë 09.03.2024 zhvilluan aktivitetin shkencor në ambientet e Muzeut Onufri në Berat. Prezantimi rreth temës “Muzeu Ikonografik Onufri, historia dhe pasuria artistike në sfidën e kohës”u bë nga drejtori i Qendrës Muzeore Berat z. Miklor Pasku, nga përgjegjësi i Muzeut Onufri z. Arjan Prifti dhe guida e Muzeut znj. Anila Droboniku.</p> <p><b>Data 9 Maj 2024</b> Panairi i Punës në “Albanian Univeristy”</p>
<b>Departamenti I Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>

